

PROTOKOLL

1. Përfaqësuesit e grupeve parlamentare të Partisë Socialiste dhe të Partisë Demokratike në prani të Kryetarit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri ranë dakort të nënshkruajnë këtë Protokoll për zbatimin e rekomandimeve të përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias të datës 23 prill 2004 mbi ligjin zgjedhor dhe administratën zgjedhore në Shqipëri (më poshtë do të quhen rekomandimet e përbashkëta).
2. Përfaqësuesit e grupeve parlamentare të PS-së dhe të PD-së riafirmuan pranimin e plotë të rekomandimeve të sipërpërmendura dhe angazhimin e tyre të plotë për t'i zbatuar ato. Ata ranë gjithashtu dakort për nevojën e një komisioni parlamentar dhe shprehën vullnetin e tyre për ngritjen e këtij komisioni.
3. Përfaqësuesit ranë dakort që detyra e këtij komisioni do të jetë zbatimi i rekomandimeve të përbashkëta përmes amendimit të kuadrit ligjor për zgjedhjet. Për këtë, ata ranë dakort të fillojnë procedurat parlamentare për krijimin e një Komisioni të Posaçëm Parlamentar për zbatimin në kohë të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it.
4. Përfaqësuesit ranë dakort për përbërjen e komisionit mbi kriteret e mëposhtme. Komisioni duhet të formohet mbi bazën e barazisë pozitive-opozitive. Komisioni duhet të jetë mjaftueshëmrisht i gjerë që të lejojë përfaqësimin e të gjitha partive parlamentare të dala nga zgjedhjet e vitit 2001. Marrëveshjet e detajuara duhet të presin kontributin e grupeve të tjera parlamentare dhe janë përgjegjësi e Kuvendit. Ata gjithashtu ranë dakort që, në interes të krijimit të vullnetit politik, shumica në vendimmarrje kërkon konsensusin e të dy grupeve parlamentare të përfaqësuara në këtë marrëveshje.

5. Përfaqësuesit rane dakort qe mazhoranca te mos shfrytezoje shumicen e saj parlamentare mbi vendimet ose propozimet e miratuara nga komisioni parlamentar ad hoc. Ata rane dakort gjithashtu qe keto vendime te miratohen me te gjitha votat e grupeve te tyre parlamentare.
6. Përfaqësuesit ranë dakort që rregullat e procedurës së komisionit të jenë sipas procedurave të përcaktuara për komisionet e përhershme parlamentare të parashikuara në Nenin 77.1 të Kushtetutës.
7. Përfaqësuesit ranë dakort për përmbushjen e shpejtë të mandatit të komisionit me qëllim trajtimin sa më të shpejtë të mundur të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës. Palët angazhohen për fillimin e menjëhershëm të punës. Ata ranë dakort që komisioni do të përfundojë punën brenda 2 muajve nga krijimi i tij. Ata ranë dakort se për përgatitjen e punës së komisionit nevojitet një grup ekspertësh teknikë.
8. Përfaqësuesit ftuan Prezencën e OSBE-së në Shqipëri të drejtojë grupin e ekspertëve të përbërë nga drejtuesi dhe 6 ekspertë, si dhe t'i sigurojë atij asistencë teknike.
9. Përfaqësuesit ranë dakort që puna e komisionit të fillojë me ndryshimin e neneve mbi përbërjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe të komisioneve zgjedhore të niveleve të tjera, si dhe me problemin e hartimit të listave në përputhje me Kodin e Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës dhe rekomandimet e përbashkëta. Përfaqësuesit ranë dakort që me nënshkrimin e këtij protokolli, ata do t'i kërkojnë Prezencës së OSBE-së në Shqipëri të organizojë grupin e ekspertëve dhe t'i paraqesë komisionit parlamentar propozimet përkatëse me ngritjen e tij. Në rastin e KQZ-së, propozimet e ekspertëve duhet të jenë gati brenda dy javëve dhe të përmbajnë formulën e përbërjes së KQZ-së, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të saj.

10. Përfaqësuesit ranë dakort që grupi i ekspertëve të përcaktojë radhën e përparësive të pjesës tjetër të programit të tij të punës.
11. Përfaqësuesit ranë dakort që në vijim të diskutimit të rekomandimeve 51-54, të diskutohet rreth mundësive për të rritur numrin e grave të përfaqësuara në Kuvend nëpërmjet listës së mandateve plotësuese.
12. Ky është një protokoll vetëm ndërmjet grupeve parlamentare të Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike dhe nuk angazhon, por fton grupet e tjera parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë. Ky Protokoll do t'i dërgoht Kuvendit të Shqipërisë, me qëllim njohjen dhe marrjen në konsideratë të tij për ngritjen e komisionit parlamentar të posaçëm për përmirësimet e Kodit Zgjedhor.
13. U ra dakort që në rast problemesh ose bllokimi në punën e komisionit, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe ekspertët kontribues do të jenë të gatshëm të japin mendime dhe këshilla teknike.

Gramoz Ruçi

Bamir Topi

Kryetar i Grupit

Kryetar i Grupit

Parlamentar të PS-së

Parlamentar të PD-së

Dëshmitar

Ambasador Osmo Lipponen

Kryetar I Prezencës së OSBE-së në Shqipëri

Tirana, 1 korrik 2004